



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 09.12.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **04.12.2024** të parashtruar nga Grupi Operatorëve Ekonomik N.M.I.Q. „ Montkomerce " Sh.p.k.; "Benita Company", dergoj Kërkesen për Rishqyrtim, lidhur me , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave" , Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-120-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit Operatorëve Ekonomik N.M.I.Q. „ Montkomerce " Sh.p.k.; "Benita Company", , e dt.04.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave" , Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-120-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 29.11.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **29.11.2024**;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Grupi Operatorëve Ekonomik N.M.I.Q. „ Montkomerce " Sh.p.k.; "Benita Company", me dt.04.12.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtegut dhe Shkugëza e sfidave", Nr. i prokurimit- 632-24-10879-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-120-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 09.12.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju si Grupi i OE, ne listën e kontratave të realizuara, nuk I keni bashkangjitur referencat dhe certifikatat për punët e kryera. Te Stafit profesional është kërkuar Master I ndërtimtarisë drejtimi Hidro, ndërsa është prezantuar me bachelor. - Lista e paisjeve është plotësuar, mirëpo nuk janë prezantuar deklaratat unike doganore, kontratat ose faturat për shumicën e pajisjeve. Poashtu Gjysem rimorkio është prezantuar me tonazhe me të ulët se që është kërkuar në FDT-ën.

Ju sqarojmë se kriteri që kontrata i ipet Operatorit ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët përcaktohet në nenin 27, paragrafet 27.1 dhe 27.3, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022:

Neni 27

Kriteret e Dhënies së Kontratës

27.1 Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të kriterit:

- a. Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ose*
- b. Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm*

27.3 Nëse kriteri "tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët" është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ulët që përmbushë kërkesat e specifikuara. Nëse kriteri është "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", kontrata duhet të jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit AK mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës, siç janë:

- a. Karakteristikat e cilësisë*
- b. Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë*
- c. Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme*
- d. Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike*

Pretendimet tuaja lidhur Operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë :

Pretendimi juaj, i parë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar certifikatën për Siguri dhe shëndet në punë të ing.termoteknikës Fuat Pallaska siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar certifikatën për Siguri dhe shëndet në punë të gjeometrit Ukë Komani, siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar certifikatën për Siguri dhe shëndet në punë të elektriksit Florin Komani, siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i katërt, nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar certifikatën për Siguri dhe shëndet në punë të hekurthyesit Kujtim Rexha, siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i pestë nuk qëndron, sepse kërkesa e Autoritetit kontraktues në FDT-ë për certifikatën për Siguri dhe shëndet në punë, është kërkuar vetëm për stafin profesional.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

